



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2792/13 prot.

Datë 05.01.2024

V E N D I M
Nr. 02/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1322/2023, datë 19.12.2023, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e peseqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujës-jellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujës-jellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A me adresë Lagjja 3 Heronjtë, Rruga “Marin Biçikemi”, Shkodër
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 19.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1322/2023, ku vendosi:

1. *Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente”, me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2451/1 prot., datë 28.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2792/10 prot., datë 03.01.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1322/2023 datë 19.12.2023.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.2451/1 prot., datë 28.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2792/10 prot., datë 03.01.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1322/2023 datë 19.12.2023.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania

Distribution Chemicals” SHPK dhe ka korigjuar shkeljet e konstatuara në përputhje me vendimin e KPP-së Nr. 1322/2023 datë 19.12.2023.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A e ka zbatuar vendimin Nr. 1322/2023 datë 19.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

